

VENDIM
Nr. 151, datë 11.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
PROCEDURAVE TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA OSHEE
SHA TE SHOQËRITË E LICENCUARA PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19; 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me “Miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, OSHEE sh.a. ka detyrimin të draftojë dhe të dërgojë për miratim në ERE, rregulloren “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

- Rregullorja është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, modelit të tregut të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 dhe “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008, i rishikuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti